KQZ
U PROTOKOLLUA
NR 4136 PROT
DATE 22.05.19

**ENKELEJDA ALITE**
**NIPT L01606037A**
**Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**
**Mob. +355 (0)67 2005022**
**e-mail:enkealite@yahoo.com;**

**Tiranë, më 21.05.2019**

**Lënda:** **Relacion në lidhje me misionin e auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2018 të Partisë Aleanca Europiane Ekologjike**

**Për:** Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve
**Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Ju lutem bashkangjitur do të gjeni praktikën për misionin e auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2018 për Partinë Aleanca Europiane Ekologjike.

Me respekt,

**Enkelejda Alite**
**Auditues Ligjor**

ENKELEJDA ALITE
EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR
Nipt : L 01606037 A
TIRANE - ALBANIA

**ENKELEJDA ALITE**
**NIPT L01606037A**
**Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**
**Mob. +355 (0)67 2005022**
**e-mail:enkealite@yahoo.com;**

**Tiranë, më 21.05.2019**

**Lënda: Informacion për mosrealizimin e kontratës së auditimit për Partinë Aleanca Europiane Ekologjike**

**Për:** **Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve**
**Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin te Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr.112, datë 27.03.2019, jemi caktuar me cilesine e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2018 për pesë Partitë Politike, midis të cilave ishte dhe Partia Aleanca Europiane Ekologjike.

Menjëherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, më datë 23.04.2019, kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me Partinë Aleanca Europiane Ekologjike për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit të letrave rekomande, në adresën e selisë së partisë siç ishte përshkruar në dokumentin e dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë drejtuar KQZ-së dhe në adresat që na dërgoi KQZ-ja në vazhdim.

Por kjo mënyrë komunikimi rezultoi pa sukses, pasi ne nuk morem pergjigje ne lidhje me kete leter.
Për këtë Parti u përdorën gjithashtu dhe komunikimet që mundëm të merrnim nga ekspertët paraardhës në misione të ngjashme, si dhe numri telefonit 04 2247294 i vënë në dispoziocin nga KQZ-ja, kërkime në internet por dhe kjo mënyrë nuk solli rezultat.

Ne besojmë se kemi bërë përpjekjet e duhura për të vendosur komunikimin zyrtar me kryetarin dhe personat e tjerë përgjegjës në Parti por kjo qe e pamundur dhe për rrjedhim misioni i auditimit për Partinë Aleanca Europiane Ekologjike nuk u realizua.

Bashkangjitur dokumentacioni vërtetues: Letra e dërguar me postë rekomande dhe konfirmimi i shërbimit postar për dërgimin e kësaj letre.
Ju faleminderit për mirëkuptimin!

**Enkelejda Alite**
**Audituese Ligjor**

ENKELEJDA ALITE
EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR
Nipt : L 01606037 A
TIRANE - ALBANIA

TIRANA 6
29 APR 2019

Nr: 1001
29/04/2019 10:00:44

**DEFTESE**
**PRANIMI E OBJEKTEVE POSTARE**

| | | |
|---|---|---|
| Objekti | Letra | Leter |
| KOD-BAR | RR844602263AA | |
| Derguesi | ENKELEJDA ALITE | |
| Marresi | KRYET I PARTISE ALEANCA EUROP EKOL SAZAN GURI | |
| Vend Mberritja | , TIRANA | |
| Pesha | 10 gr | |

**Tarifa total** **70**

Nenshkrimi: Marjola Odobashi

ENKELEJDA ALITE
NIPT L01606037A
Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane
Mob. +355 (0)67 2005022
e-mail:enkealite@yahoo.com;

Tiranë, më 28.04.2019

**Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurave të auditimit ligjor.**

**Për Partinë Aleanca Europiane Ekologjike (AEE)**
**Drejtuar kryetarit: Z. Sazan Guri**
**Adresa e selisë: Rruga Abdyl Frashëri, Pall.3/3,Tiranë**

Me vendimin Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr.112, datë 27.03.2019, jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga Partia Aleanca Europiane Ekologjike (AEE) për vitin kalendarik 2018, të deklaruara në raportin financiar vjetor dhe në raportime të tjera financiare dorëzuar KQZ-së për këtë periudhë.

Sipas kontratës nr.1313/1 prot. datë 23.04.2019, me palën angazhuese KQZ-në, objekti i misionit të auditimit eshtë: *"Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2018, nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre"* dhe afati kufi i përfundimit të procesit te auditimit eshte 22 Maj 2019.

Për kryerjen me sukses të misionit, brenda kohës së përcaktuar në kontratë, ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit që merret me shërbimin kontabël për të na berë të disponueshëm dokumentacionin kontabël,rregjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.

Ju lutem konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na krijoni mundësinë e një takimi në selinë e partisë tuaj sa më shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar termat e angazhimit të auditimit.

Përgjigjjen drejtoheni në adresën në krye të shkresës.

Faleminderit!

Enkelejda Alite
Auditues Ligjor(EKR)

ENKELEJDA ALITE
EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR
Nipt: L 01606037 A
TIRANE - ALBANIA